



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 16 tetor 2014, në mbledhjen e X-të ( dhjetë ) – jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.15'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, z. Islam Revuci Fidan Rekaliu , Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahu – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe mirëqenies Sociale, z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së.

### Rendi i Ditës

#### 1. Propozimi i Vendimit për ri – alokim dhe transfer të projekteve përvitin 2014

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, i paraqiti sqarimet për nevojën e thirrjes të kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme.

z. **Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financa, e paraqiti fjalën hyrëse.  
z. **Agron Hyseni**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe mirëqenies Sociale, theksoi, për mbulimin e gjithmbarshëm të kontratës për ndërtimin e shtëpive të karakterit social nevojiten edhe 10.816 € dhe propozoi që këto mjete të merren nga projekti për renovimin e objekteve shëndetësore, propozim i cili në formë të shkruar ju dorëzua para fillimit të mbledhjes.

**z. Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, e paraqiti fjalën e hyrjes lidhur me projektet në kompetencë të Drejtorisë së cekur.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, sa e kuptova drejtorin z. Isuf Latifi, tha se mosfunkcionimi i Pushtetit qendror bartet edhe te ne, nuk mund të pajtohem me atë konstatim ngase përgjegjësitë janë të ndara dhe Komuna mund t'i përmbush përgjegjësitë e veta pa kurrfarë problemi, andaj nuk duhet ta fajësoj askënd.

Ri-alokimi për të cilin jemi duke debatuar, sipas mendimit tim, është defekt i mos planifikimit të mirë të buxhetit për vitin përkatës. Ne në vazhdimësi kemi kërkuar që qeverisja komunale të ketë planifikim detaj, mirëpo kjo deri tash nuk është marrë parasysh dhe për këtë shkak jemi të detyruar që çdo 2-3 muaj të bëjmë ridestinime të mjeteve.

Dy vitet e fundit e kemi kolektorin e ujërave të zeza në fshatin Gllamnik dhe përveç këtij projekti edhe në raste tjera mjetet herë barten në një projekt tjeter herë kthehen në të njëtin projekt, këtë unë nuk mund ta kuptoj.

Tri vite radhazi në prioritete është rregullimi i shtratit të lomit në Batllavë duke filluar nga penda e liqenit por asnjëherë nuk kanë filluar punimet.

Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale propozoi që të merren mjetet e parapara për renovimin e objekteve shëndetësore dhe të barten në projektin për ndërtimin e shtëpive të karakterit social, për mua kjo është e pakuptueshme.

**z. Haki Rudari**, theksoi, dëshiroj të filloj nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht fjalën e drejtorit që tha se për projektin prej 100.000 €, mungojnë edhe 10.000 € dhe ato duhet të ridestinohen, ky rast është dëshmi se ne po miratojmë projekte pa mbulesë.

Sipas emërtimit të propozimit të këtij vendimi rezulton se Drejtoritë e Komunës nuk kanë planprogram të punës qoftë gjashtëmujor apo njëvjeçar, të them kushtimisht ashtu siç e kemi ne në arsim, ngase sikur ta bënин planprogramin nuk do të kishim situata të këtilla dhe nuk do të barteshin mjetet prej një projekti në projekt tjeter.

Jemi në dijeni se kur kanë qenë vërshimet, nga ana e Drejtorive përkatëse ka pas fjalë të mëdha për mbështetje të trevave që kanë qenë të prekura nga vërshimet, mirëpo po vërehet se nuk ka ri-alokim të mjeteve në këtë drejtim.

Jam që mjetet të ri-alokohen por që mjetet të merren nga projektet e kryera dhe barten në projekte të tjera, pra nuk jam për atë që ndonjë projekt të mos kryhet dhe mjetet të barten në projekt tjeter.

Jam i mendimit se është plotësisht e paarsyeshme që nga projekti i Lupçit të barten në projekt tjeter kur qytetarët e asaj treve u ekspozohen rreziqeve të ndryshme.

E gjithë kjo është pasojë e mungesës së projekteve, projekti nuk mund të lëvizë, shuma duhet të jetë e përcaktuar dhe nuk duhet të ketë ngritje të shumave.

Marrë në përgjithësi po e vërej se ky ri-alokim u bë për qëllime, për mua, jo të arsyeshme ngase po lëmë projekte të papërfunduara dhe po bartim mjete në projekte të tjera.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, në shumë mbledhje kemi debatuar dhe nuk po mundemi të dalim prej rrethit vicioz të investimeve nëpër fshatra nga vijnë drejtorët e Drejtorive. Në këtë ri-alokim shqetësuese është se 90% të ri-alokimit

shkon në tri apo katër fshatra dhe atë në Llapashticë, Dumnicë, Bradash dhe Revuç.

Nuk mund të themi se po bëjmë qeverisje të mirë, rast mund të marrim projektin e kanalizimit në Dumnicë ngase mënyra dhe punimet që janë duke u bërë atje në masë të madhe e kanë degraduar dhe ndotur ambientin dhe të alokohen mjete në atë projekt, mendoj se është shumë e pa arsyeshme. Përndryshe konsideroj se Kryetari i Komunës do duhej menjëherë të ndalone vazhdimin e punimeve në projektin e cekur.

Kërkoj sqarime se me mjetet për hartimin e projekteve zbatuese cilat projekte janë paraparë të hartohen gjithashtu edhe për atë se cilat rrugë konkrete janë shtruar me zhavorr.

Mjetet për ndërtimin e dhjetë shtëpive të karakterit social kanë qenë të ndara dhe jam i mendimit se 10.200 € për një shtëpi kanë qenë të mjaftueshme, këtë e them nga përvoja që kam pas në ndërtimin e shtëpive të karakterit humanitar, andaj jam në dijeni se sa kushton një shtëpi e vogël sociale dhe tash të merren mjetet prej elementit primar që janë arsimi e shëndetësia, në rastin konkret prej shëndetësisë nuk mund të pajtohem ngase është tejet e rëndësishme mirëmbajtja e Qendrave të Mjekësisë Familjare, por nëse është vetëm për këtë vit as unë nuk jam kundër që të ri-alokohen 10.000 € në mënyrë që të përfundoj projekti për ndërtimin e dhjetë shtëpive të karakterit social.

Në fund dua të them se jam kundër këtij ri-alokimi e arsyaja kryesore është ajo që e ceka më parë se mjetet kryesisht ri-alokohen në katër fshatra.

**z. Kumrie Hoti**, theksoi, nuk jemi kundër që të ridestinohen mjetet për ndërtimin e shtëpive të karakterit social, mirëpo duke u bazuar se unë punoj në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kërpimeh dhe jam dëshmitare se jo vetëm ajo QMF por edhe QMF – të tjera nuk janë të kompletuara duke filluar nga uji i pjes siç është rasti i QMF – së në Pollatë, pastaj mungesa e aparaturave të ndryshme, shtrohet pyetja a është në rregull që mjetet e shëndetësisë të ri-alokohen në ndërtimin e shtëpive të cekura.

QMF në Kërpimeh është hapur në vitin 2012 kinse punën e ka filluar me aparatura shumë moderne por kjo nuk është e vërtetë se aparaturat janë të vjetra dhe të prishura dhe vetëm për një sediment pacientët janë të detyruar të vijnë në Podujevë dhe atë vetëm për shkak të një aparature shumë të thjeshtë por edhe në mungesë të stafit të nevojshëm.

Përndryshe QMF në Kërpimeh është bërë si transit i punëtorëve, fillimisht i sjellin me kontrata mbi vepër e pastaj i tërheqin gjetiu.

**z. Afrim Shabani**, theksoi, bazuar në atë se bëhet fjalë që shuma e caktuar e projekteve përkatëse nuk mjafton për realizimin e plotë të tyre dhe shtrohet nevoja që mjete konkrete të barten tek ato projekte, unë jam i pajtimit të bëhen këto ri-alokime.

Sa i përket asaj çfarë tha z. Kumrie Hoti, pajtohem se ka mungesë të punëtorëve shëndetësor mirëpo problematika qëndron në kufizimin e numrit të punëtorëve shëndetësor e sa unë jam në dijeni është 246 punëtorë shëndetësor e rritjen e këtij numri nuk e lejon Ministria kompetente.

Pajtohem gjithashtu se në të gjitha QMF – të ka nevojë për renovime, mirëpo nëse ri-alokimi i mjeteve konkrete ka të bëjë vetëm me këtë vit, atëherë pajtohem me këtë propozim.

**z. Kumrie Hoti**, theksoi, unë do të përqendrohem vetëm për QMF në Kërpimeh ku edhe punoj, aty ka nevojë vetëm për një laborant, përndryshe mund të them se jemi të ngarkuar me staf e kjo gjendje është se bëhet vetëm për interes personal të ndokujt.

**z. Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financa, Kuvendi e ka miratuar rishikimin e buxhetit për vitin 2014, mirëpo për shakat tē pamundësisë për tu miratuar në Kuvendin e Kosovës, jemi detyruar tē bëjmë ri – alokim.

Për rishikim tē buxhetit as Qeveria e as Kuvendi i Kosovës nuk kërkojnë asnjë arsyetim, ndërsa për ri-alokim për tē gjitha rastet jemi tē detyruar tē bëjmë arsyeshmëritë detaje.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, jam i interesuar tē di se si mund tē lidhet kontrata për ndërtimin e shtëpive tē karakterit social në shumë 110.000 € kur për këtë projekt është miratuar shuma 100.000 €.

**z. Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, debati është duke u zhvilluar më tepër për politikat e projekteve se sa për ri-alokimet konkrete. Përndryshe tē njëjtat gjëra jemi duke i përsëritur disa herë.

Në fakt këtë çështje e kemi shtruar për debat me qëllimin ma tē mirë që tē bëjmë ri-alokim ligjor dhe profesional dhe që e stabilizon buxhetin e Komunës, edhe pse këtë vit për fat tē keq rreziku për suficit është shumë i madh, pra në njérën anë tē kemi suficit dhe në anën tjetër punë tē kryera dhe tē papaguara.

Sikur tē ishte miratuar rishikimi i buxhetit nga ana e Kuvendit të Kosovës shumë probleme do tē ishin tē zgjidhura dhe nuk do tē kishim nevojë tē bëjmë ri-alokim. Sa i përket hartimit tē projekteve zbatuese, në Kuvend e kam sqaruar mjaftë mirë, mjetet përkatëse janë planifikuar për hartimin e projektit tē kolektorit Batllavë – Gërdoc, kolektorit Gllamnik – Kunushec dhe urave në fshatrat Repë dhe Murgullë.

**z. Agron Hyseni**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, z. Kadri Avdiu, kërkoi sqarime lidhur me ri-alokimin e mjeteve në shëndetësi, lidhur me këtë mund tē them se nuk kanë tepruar mjetet për renovimin e objekteve shëndetësore por është mungesë në projektin për ndërtimin e shtëpive tē karakterit social nevojiten në shumë prej 10.816 € dhe se mundësia e vetme ka qenë që këto mjete tē merren nga kodi i cekur.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, duhet ta kemi tē qartë se vërejtjet i bëjmë me qëllimin më tē mirë dhe për ju këto duhet tē jenë tē mirëseardhura.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave me fjalë po e arsyeton shumë mirë por nuk jepen sqarime tē nevojshme përse bëhen ri – alokimet konkrete dhe nuk specifikohen në mënyrë tē duhur. Gjithashtu planifikimi i projekteve nuk bëhet ashtu si do duhej ngase parashihen projekte me shuma tē vogla në disa fshatra, shuma me tē cilat nuk mund tē realizohen ato projekte, por kjo bëhet me qëllim që më vonë ato mjete tē ri-alokohen.

Për projekte tē papërfunduara parashihen shuma tē caktuara mirëpo nuk specifikohen se cilat janë ato projekte dhe në cilin vit kanë qenë në prioritete.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit përmes ekspertëve duhet ta dijë se ku është e nevojshme tē ndërtohen kolektorët, a tē vendosen në fshatin e sipërm apo atë tē poshtëm në mënyrë që investimet tē jenë sa më rationale.

**z. Fidan Rekaliu**, theksoi, jam i mendimit se ky ri-alokim duhet të përkrahet ngase është bërë në mbështetje të dispozitave ligjore dhe projektet nuk kanë të bëjnë me disa fshatra por me dhjetëra fshatra, pra asnjëherë nuk kemi shkuar në ndarje që u përmenden gjatë debatit, andaj është e domosdoshëm që të miratohet.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, është e kuptueshme të ri-alokohen mjetet e grantit të Qeverisë për t'i shmangur suficitit përkatësisht humbes së mjeteve të pashfrytëzuara, mirëpo nuk e kuptoj përsë ri-alokohen mjetet nga të hyrat vetanake e që janë rreth 200.000 € kur dihet se të hyrat vetanake janë të sigurta, pra edhe nëse nuk shfrytëzohen në vitin përkatës ato lirshëm mund të shfrytëzohen në vitin vijues.

Parafolësi tha se ri-alokimi nuk ka të bëjë me tre apo katër fshatra, mirëpo në dokumentin të cilin na e keni dërguar janë katër fshatra në të cilat investohen një milion euro e këto fshatra janë Dumnica, Llapashtica, Bradashi dhe Revuçë.

**z. Haki Rudari**, theksoi, nuk mund të themi se është e arsyeshme të merren mjetet siç janë fshatrat Surdull dhe Lupç ngase ne duhet pasë konsideratë ndaj fshatrave malorë dhe do duhej që gjithnjë të jenë në prioritete.

Pajtohem që mjetet të merren nga projektet e përfunduara dhe të ri-alokohen në projektet ku shtrohet nevoja, por jam kundër asaj që mjetet të merren nga projektet e papërfunduara meqë në këtë raste mbeten mungesa të mjeteve.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, rishikimi i buxhetit është e drejtë ligjore dhe mbi këtë bazë Kuvendi i Komunës e ka miratuar Vendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2014, mirëpo ky vendim nuk është i zbatueshëm ngase, për arsyë të njoitura, rishikimi i buxhetit nuk është miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Në një situatë të këtillë e vëtmja mundësi ka qenë ri-alokimi për të cilin jemi duke debatuar dhe nëse nuk bëhet ri-alokimi do të kemi deficitë të madh buxhetor. Kjo mënyrë është rregullator ku ka tepricë të mjeteve merren dhe paguhen borxhet apo të plotësohen për projekte ku mungojnë mjetet.

Parafolësi e përmendi fshatin Surdull, me 60.000 € nuk munden me u krye punimet përkatëse, mirëpo kjo shumë është paraparë për participim nëse eventualisht sigurohet ndonjë donacion nga Ministritë përkatëse.

Gjatë debatit u përmend se për ndërtimin e shtëpive të karakterit social kanë qenë të parapara 100.000 € dhe shtroi pyetjen përsë është lidhur kontrata për mbi shumën e cekur, lidhur me këtë jeni në dijeni se tenderi është publik dhe sigurisht kontrata është lidhur me ofertuesin me çmimin më të lirë, përndryshtë është e pamundur të parashihet kostoja e cilitdo projekt në kushtet e konkurrencës, pra ofertat janë të lira.

Propozimin e vendimit së bashku me propozimet e dhëna gjatë debatit i vuri në votim.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, Komiteti për Politikë dhe Financa a është vetëm të bisedoj apo kur vlerëson se është e nevojshme edhe me i rekomanduar Kuvendit çështje të caktuara, pra a jemi vetëm me bërë amin.

Ne gjatë debatit i ngritëm shqetësimet tona për gjërat të cilat konsiderojmë se nuk janë në rregull, mirëpo ne nuk mund t'i mbështesim blanko propozimet e juaja.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, po ndërlidhem me atë që tha kryesuesi se për ndërtimin e shtëpive sociale është lidhur kontrata me ofertuesin i cili e ka pasë

çmimin më të lirë, lidhur me këtë shtrohet pyetja sikur ai çmim të ishte 170.000 € a ka pas mundësi të lidhet kontrata përkatëse. Me Ligjin e Prokurimit Publik nëse vijnë ofertat më shumë se mjetet e parapara, tenderi duhet të përsëritet apo në rastin konkret të ndërtoheshin vetëm 9 shtëpi në vend të 10 shtëpive të parapara. Jam në dijeni se 10.000 € nuk janë mjete të shumta me të cilat do të bëhej ndonjë, investim kapital apo zgjidhej ndonjë problem tjetër, mirëpo rregullat janë të këtilla.

*Pas votimit u konstatua se me shumicë votash, përkatësisht me 6 vota për, 5 vota kundër dhe asnjë votë të përbajtur, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim, me ndryshime dhe plotësime, si vijon:*

- Nga projekti për renovimin e objekteve shëndetësore, kodi nr. 85257 në shumë 20,000.oo €, merret shuma prej 10,816.11 €, dhe ri-alokohet në projektin për ndërtimin e shtëpive për raste sociale kodi nr. 85260.
- Në titullin e kapitullit IV ku thuhet Rregullimi i mjeteve nga të hyrat vetanake, të korrigohen Ri-alokimi i mjeteve...
- Propozimit të vendimit t'i shtohen edhe dy pikat, përkatësisht;

**V.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2014 nr. 01-400-60469 të datës 18 korrik 2014.

**VI.** Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

**Mbledhja përfundoi në orën 14.20'.**

**Procesverbalin e mbajti**  
**Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-89548**  
**Podujevë,**  
**16 tetor 2014**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Mehmet Gashi**